



Sektori i Drejtësisë Penale/Grupi i Punës për Shtetin e së Drejtës

Memorandumi i Rabatit për Praktikën e Mira për një Praktikë të Efektshme Antiterrorizëm në Sektorin e Drejtësisë Penale

Hyrje

Deklarata e Kairos kundër Terrorizmit dhe për Shtetin e së Drejtës (22 shtator 2011) iu bënë thirrje anëtarëve të Forumit Botëror të Antiterrorizmit (FBAT) që “të zhvillojnë praktika të mira për një reagim, efikas dhe të bazuar tek shteti i së drejtës, të sektorit të drejtësisë penale ndaj terrorizmit, përfshirë ato aspekte që lidhen me bashkëpunimin ndërkombëtar.” Sektori i drejtësisë penale/grupi i punës për shtetin ligjor i FBAT-së u takua në Uashington, D.C. në datat 3-4 nëntor, 2011, për të diskutuar lidhur me rolin e autoriteteve të drejtësisë penale në hetimin dhe përçarjen e aktiviteteve terroriste. Ky diskutim dhe takimi vijues në Rabat, në datat 7-8 shkurt, 2012, rezultuan në hartimin e këtij dokumenti për praktikën e mira antiterrorizëm të drejtësisë penale. Në të njëjtën linjë me deklaratën e Kairos, të gjitha shtetet inkurajohen që të marrin në konsideratë përdorimin e këtyre praktikave të mira jo të detyrueshme, ndërsa pranojnë që zbatimi i këtyre praktikave duhet të jetë i pajtueshëm me të drejtën ndërkombëtare në fuqi, ashtu si edhe me ligjin dhe rregulloret kombëtare, duke marrë parasysh historinë, kulturën dhe sistemet ligjore të ndryshme nga shteti në shtet. Gjithashtu, shtetet inkurajohen, por nuk detyrohen, që të ndajnë përvojat e tyre lidhur me praktikën e përmendura më poshtë në Grupin e Punës. Këto praktika të mira për trajtimin e terrorizmit duhet të ndërtohen në një sistem funksional të drejtësisë penale që është në gjendje të merret me veprat penale të rëndomtë, ndërsa mbron të drejtat e njeriut të të akuzuarve.

Në shprehjen qartë të këtyre praktikave të mira, Grupi i Punës pranon që objektivi kryesor i çdo reagimi të efektshëm të drejtësisë penale ndaj terrorizmit është të parandalojë incidentet terroriste para se ato të prodhojnë një numër të madh të lënduarish apo rezultate të ngjashme rrënuese, ndërkohë që respektojnë tërësisht të drejtën ndërkombëtare në fuqi dhe promovojnë shtetin e së drejtës. Gjithashtu, sistemi i drejtësisë penale duhet të jetë në gjendje që të reagojë ndaj akteve terroriste me hetime, ndjekje penale dhe ndëshkim të drejtë dhe të efektshëm në rastin fatkeq kur ndodhin. Për pasojë, një strategji gjithëpërfshirëse kërkon një qasje të integruar dhe një sistem me bazë të gjerë veprash penale, përfshirë ato të sapofilluara apo parandaluese, si tentativa, komplotim, ofrimi i mbështetjes material, trajnimi, nxitja dhe kërkesa. Nevoja për një kuadër ligjor që mundëson hetime të efektshme dhe bashkëpunim të fortë mes hetuesve, prokurorëve, gjyqtarëve (aty ku kjo është relevante) dhe zyrtarëve të tjerë të qeverisë ka po të njëjtën rëndësi për dispozitat e veprës penale. Gjithashtu, në çështjet penale janë thelbësorë mekanizmat e zhdërvjellët të bashkëpunimit ndërkombëtar për të parandaluar dhe për t’iu përgjigjur terrorizmit në mënyrë të efektshme dhe me efikasitet.

Është me shumë rëndësi që shtetet, aty ku është e përshtatshme, të kenë autoritetet e nevojshme ligjore për të bërë mbikëqyrje të fshehtë të të dyshuarve si terroristë, për të mbledhur prova lidhur me aktivitete terroriste, prova që mund të përdoren në gjykatë, për të ndaluar të dyshuarit bazuar në këto prova, për të marrë informacion prej tyre lidhur me komplotin terrorist për të t’i ndjekur ata penalisht në mënyrë të drejtë dhe të efektshme në procedurat ligjore dhe t’ju mundësojnë atyre që dënohen ndëshkim të përshtatshëm dhe ambiente korrektuese. Të gjitha

këto masa dhe zbatimi i tyre duhet të respektojnë tërësisht detyrimet e të drejtave të njeriut dhe shtetin e së drejtës, ndërkohë që mbrojnë sigurinë e atyre që marrin pjesë në proces dhe burimet e metodat e ndjeshme të qeverisë. Grupi i Punës njih se në përpjekjen kolektive për të luftuar e parandaluar terrorizmin nuk duhet të harrojmë të vërtetën që “Të gjithë njerëzit lindin të lirë dhe të barabartë në dinjitet dhe në të drejta. Ata kanë arsye dhe ndërgjegje dhe duhet të sillen ndaj njëri tjetrit me frymë vëllazërimi”.¹

Veprat e terrorizmit mohojnë vetë lirinë, dinjitetin dhe arsyen e natyrshme që zotërojnë të gjithë njerëzit; por sistemet tona të drejtësisë penale, sidoqoftë, duhet t’u mundësojnë atyre të akuzuarve për vepra terroriste të drejtat themelore të njeriut, që të gjitha shoqëritë e lira i mbajnë gjallë. Për pasojë, në mënyrë që të mbrohen të drejtat themelore të njeriut të të gjithë personave siç thuhet në *Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut*, duhet të ketë një gjyqësor kompetent të pavarur dhe të paanshëm dhe zyrtarët e zbatimit të ligjit duhet të punojnë brenda një kuadri të shtetit të së drejtës që siguron proces të drejtë për të akuzuarit dhe mbrojtjen e duhur për liritë civile.² Politikat antiterrorizëm, të forta dhe të efektshme, nuk bien në kundërshtim me respektimin e të drejtave të njeriut. Përkundrazi, Shtetet që kanë zhvilluar mjete të forta, të ligjshme për hetimin dhe ndjekjen penale të terroristëve të dyshuar, në përputhje me të drejtën ndërkombëtare në fuqi kanë më shumë gjasa t’i respektojnë të drejtat e njeriut në ndjekjen e këtyre të dyshuarve. Veç kësaj përpjekjet antiterrorizëm janë të suksesshme më së miri, kur bazohen në detyrimet e të drejtave të njeriut dhe tek shteti i së drejtës.

Grupi i Punës thekson që nuk mjafton thjesht ekzistenca e disa mjeteve ligjore. Një reagim gjithëpërfshirës i drejtësisë penale ndaj terrorizmit kërkon një sistem të fortë të drejtësisë penale që funksionon në praktikë. Kjo kërkon që agjencitë hetimore, prokurorët, gjyqtarët hetues (aty ku ata janë relevantë) të kapërcejnë barrierat institucionale dhe të punojnë ngushtë e të bashkëpunojnë, ndërsa respektojnë rolet e tyre përkatëse. Barrierat institucionale që shpesh pengojnë bashkëpunimin e efektshëm kundër terrorizmit midis organeve qeveritare mund të jenë po aq domethënëse për sistemin sa është legjislacioni i mangët. Gjithashtu, aktorët në sektorin e drejtësisë penale duhet të marrin trajnimin dhe burimet e nevojshme për të ndërtuar kapacitetin e tyre në mënyrë që të kryejnë përgjegjësitë e tyre.

Të gjitha vendet inkurajohen që të marrin në konsideratë listën jo shteruese vijuese të praktikave të mira të rekomanduara për një reagim, të efektshëm dhe të bazuar në sundimin e ligjit, të sektorit të drejtësisë penale kundër terrorizmit. Shumë prej tyre janë pasqyruar tashmë në rezolutat e Këshillit të Sigurimit të OKB-së dhe praktikat analoge janë pasqyruar në traktatet shumëpalëshe ndaj krimit të organizuar, trafikut të drogës, të drejtat e njeriut, dhe çështje të tjera.

Në formulimin e këtyre praktikave të mira të rekomanduara, Grupi i Punës është mbështetur tek konventat ekzistuese të Kombeve të Bashkuara, si dhe tek përvoja, analiza dhe botimet e Kombeve të Bashkuara dhe agjencive të saj të specializuara. Kjo listë e praktikave të mira të FBAT-së nuk është shteruese. Grupi i Punës mund të zgjedhë që ta zgjerojë ose modifikojë atë për të marrë parasysh përvojat e shteteve në përdorimin e sistemeve të tyre të drejtësisë penale për të parandaluar dhe luftuar terrorizmin.

¹ *Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut*, U.N. Ga. Rez. 217 Neni 1(10 dhjetor, 1948).

² *Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike*, Hyrje, 999 U.N.T.S. 171 (16 dhjetor 1966), [më poshtë PNDKP]. [“Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të trajtohet me paanësi dhe publikisht nga një gjykatë kompetente, e pavarur dhe e paanshme, e ngritur sipas ligjit, që do të vendosë qoftë për përcaktimin e çdo akuze të karakterit penal që drejtohet kundër tij, qoftë për konfliktet lidhur me të drejtat dhe detyrimet e tij në fushën civile.” Neni 14.1, PNDKP]

A. Mjetet e Procedurës Penale

- *Praktika e Mirë 1: Mbrojtja e viktimave, dëshmitarëve, informatorëve, agjentëve të fshehtë, jurive, hetuesive, prokurorëve, avokatëve mbrojtës dhe gjyqtarëve në rastet e antiterrorizmit.* Viktimat, dëshmitarët, informatorët agjentët e fshehtë, juritë, hetuesit, prokurorët, avokatët mbrojtës dhe gjyqtarët luajnë që të gjithë rol thelbësor në hetimin e, dhe në procedurat gjyqësore që përfshijnë, vepra terroriste. Aftësia e tyre për të marrë pjesë në hetimet e agjencive ligjzbatuese dhe/ose procedurat gjyqësore pa patur frikë nga frikësimi apo nga hakmarrja është thelbësore në mbajtjen e shtetit të së drejtës. Duhet të ekzistojnë procedura ligjore dhe masa praktike për mbrojtjen e tyre dhe të anëtarëve të caktuar të rrethit të ngushtë familjar.³

Në lidhje me dëshmitarët që nuk kanë përfshirje kriminale, ata duhet të kenë besim në sigurinë e tyre, si dhe besim në integritetin dhe përgjegjshmërinë e sistemit gjyqësor, në mënyrë që të ndihen të sigurt në bashkëpunim me zyrtarët e sektorit të drejtësisë. Në mënyrë të ngjashme, programet e mbrojtjes së dëshmitarëve dhe përpjekjet e tjera për të garantuar sigurinë e dëshmitarëve, informatorëve dhe agjentëve të fshehtë të cilët mund të kenë marrë pjesë në aktivitete kriminale janë një mjet i rëndësishëm për krijimin e stimujve për bashkëpunimin e tyre. Shtetet duhet të marrin në konsideratë zhvillimin e programeve të nevojshme për mbrojtjen në këtë drejtim që mund të përfshijë mbrojtje për anëtarët e rrethit të ngushtë familjar. Këto programe duhet të kenë burime të mjaftueshme që të jenë të efektshme në praktikë. Shtetet inkurajohen që të zhvillojnë marrëveshjet e bashkëpunimit ndërkombëtar në mënyrë që të sigurojnë mbrojtje për dëshmitarët kur një gjë e tillë është e përshtatshme.⁴

- Të drejtat e viktimave duhen mbrojtur. Kjo përfshin të drejtën për mbrojtje, ndihmën e duhur dhe mbështetje gjatë procedurave penale.⁵ Në miratimin dhe zbatimin e masave të tilla, Shtetet do të sigurojnë që prokurorët dhe gjykatat t'i trajtojnë viktimat në mënyrë të drejtë në procesin e drejtësisë penale. Përveç kësaj, shtetet duhet të marrin parasysh masat e nevojshme për të siguruar mbrojtjen e avokatit, veçanërisht kur ata përfaqësojnë informatorë, duke respektuar aftësinë e tyre për t'u siguruar përfaqësim të fuqishëm klientëve të tyre.

³Mbrojtja e dëshmitarëve nga kërcënimet dhe hakmarrja është një komponent i rëndësishëm konventave të Kombeve të Bashkuara. “Çdo Shtet Palë duhet të marrë masat e duhura brenda mundësive të tij për të siguruar mbrojtje efektive nga hakmarrja ose kërcënimi i mundshëm i dëshmitarëve në proceset penale.” Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar, neni 24.1; [UNTOC]; Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit [UNCAC], neni 32.1. Këto masa përfshijnë mbrojtjen fizike të dëshmitarëve, transferimin, mos zbulimin e identitetit dhe vendndodhjes së tyre, si dhe rregullat që ju mundësojnë atyre të dëshmojnë pa qenë të pranishëm personalisht. UNTOC, neni 24.2; Konventa e OKB-së kundër korrupsionit UNCAC, neni 32.2. Këto konventa kanë bërë thirrje gjithashtu për kriminalizimin e “përdorimit të forcës fizike, kërcënimeve apo frikësimeve ... për të ndërhyrë në dhënien e dëshmisë ose prodhimin e provave [ose] për të ndërhyrë në ushtrimin e detyrave zyrtare nga ana e një zyrtari të drejtësisë apo të zbatimit ligjit.” UNTOC, neni 23; UNCAC, neni 25.

⁴ Udhëzuesi teknik për zbatimin e rezolutës 1373 at 28 (2001).

⁵ Këto të drejta janë njohur në konventat e OKB-së që iu bëjnë thirrje shteteve palë të “marrin masat e duhura brenda mundësive [të tyre] për të siguruar ndihmë dhe mbrojtje për viktimat ... në mënyrë të veçantë në rastet e kërcënimit nga hakmarrja ose frikësimi.” UNTOC, neni 25.1. Këto masa përfshijnë “qasje tek kompensimi dhe kthimi”, dhe pasjen e “pikëpamjeve dhe shqetësimeve ... që paraqiten dhe shqyrtohen në faza të përshtatshme të procedurës penale.” UNTOC, nenet 25.2 dhe 25.3; *Protokolli i Kombeve të Bashkuara për Parandalimin, Shtypjen dhe Ndëshkrimin e Trafikimit të Personave, veçanërisht Grave dhe Fëmijëve*, nenet 6.2 dhe 6.6, 15 dhjetor, 2000, 2237 U.N.T.S. 319, Shtojca II [në vijim *Protokolli kundër Trafikimit të Personave*]. *Protokolli kundër Trafikimit të Personave* gjithashtu bën thirrje për “të mbrojtur privatësinë dhe identitetin e viktimave” përmes procedurave ligjore konfidenciale, këshillimit mbi të drejtat e tyre ligjore, “ndihmës mjekësore, psikologjike dhe materiale”, “mundësive për punësim, arsimim dhe trajnim” dhe “strehimit të përshtatshëm”, nenet 6.1 dhe 6.3. Përveç kësaj, Strategjia e OKB-së kundër terrorizmit i bën thirrje të gjitha shteteve “të marrin në konsideratë krijimin, në baza vullnetare, të sistemeve kombëtare të ndihmës që do të ndihmojnë nevojat e viktimave të terrorizmit dhe familjeve të tyre dhe do të lehtësojnë normalizimin e jetëve e tyre.” Rezoluta 60/288 e Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së (shtator 2006), Plani i Veprimit, Seksioni 1, Paragrafi 8 [këtej e tutje *Strategjia e OKB-së*].

- *Praktika e Mirë 2: Nxitja e bashkëpunimit dhe bashkërendimit midis agjencive vendase që kanë përgjegjësi apo informacion që lidhet me antiterrorizmin.* Hetimi i efektshëm i kërcënimeve terroriste shpesh përfshin mbledhjen dhe analizën e informacionit të mbledhur nga agjencitë e shumta brenda një qeverie të vetme, të tilla si shërbimi informativ, ato të zbatimit të ligjit, ato ushtarake, të financave, dhe agjencive bankare, si dhe ato shtetërore apo qeveritë vendore. Shpesh është e rëndësishme të bëhet lidhja e pjesëve të ndryshme të informacionit të marrë nga burime të ndryshme në mënyrë që të identifikohet dhe të priset një komplot terrorist dhe për të ndjekur penalisht rastet e terrorizmit. Kështu, shkëmbimi i informacionit për qëllim parandalimin e veprave terroriste, ndërmjet të gjitha agjencive të përfshira, është një mjet i rëndësishëm për parandalimin e akteve terroriste. Shtetet mund të dëshirojnë të marrin në konsideratë, kur është e përshtatshme, shpalljen e masave dhe mekanizmave që përcaktojnë një kuadër ligjor që synon rritjen e bashkëpunimit ndërmjet agjencive dhe shkëmbimin e informacionit, duke ruajtur mbrojtjen e nevojshme të të dhënave personale.⁶ Në këtë kontekst, agjentët e zbatimit të ligjit, prokurorët dhe zyrtarët e tjerë përkatës duhet të punojnë së bashku duke respektuar kompetencat e tyre, siç përcaktohet me kornizën ligjore në fuqi, për të mundësuar një sistem të efektshëm dhe të integruar të drejtësisë penale.

- *Praktika e Mirë 3: Ofrimi i një kuadri ligjor dhe masave praktike për hetimet e fshehta të dyshuarve apo organizatave terroriste.* Kur është e nevojshme dhe e mundshme, Shtetet duhet të krijojnë mekanizmat dhe legjislacionin e duhur për kryerjen e hetimeve të veprimtarisë terroriste pa dijeninë e terroristëve të dyshuar nën hetim. Prandaj, Shtetet duhet të mundësojnë, ku është e përshtatshme, përdorimin e teknikave speciale të hetimit, të tilla si hetimet e fshehta, pas procedurave të përcaktuara, siç parashikohet në ligjet ose politikat përkatëse kombëtare, që të sigurojë përgjegjshmërinë e zyrtarëve të zbatimit të ligjit, si dhe mbledhjen e dëshmive të pranueshme të veprimtarisë terroriste dhe planeve, përgatitjeve, veprimeve, dhe përfshirjes kriminale përkatëse.⁷ Është e rëndësishme që të ketë procedura për të mbrojtur nga dëmi në masën maksimale të mundshme ata që janë përfshirë në operacione të fshehta, duke siguruar ndërkohë përgjegjshmërinë e tyre. Procedura të tilla duhet të jenë të gjitha në përputhje me ligjet përkatëse kombëtare dhe të drejtën ndërkombëtare në fuqi. Është gjithashtu e rëndësishme që aktivitetet e tyre të mbikëqyren nga afër për të siguruar që ato t'i drejtojnë operacionet e tyre në bazë të dëshmive të veprimtarisë terroriste, që të kryejnë operacionet brenda kufijve të duhur të të drejtave të njeriut, dhe që të mos angazhohen në ngritjen e kurtheve.

- *Praktika e Mirë 4: Ofrimi i një kuadri ligjor dhe masave praktike për mbikëqyrjen elektronike gjatë hetimeve antiterrorizëm.* Natyra klandestine dhe komplekse e terrorizmit kërkon metoda dhe teknika të specializuara hetimore. Format e miratuara ligjorisht të mbikëqyrjes elektronike, të tilla si përgjimi, pajisjet gjurmuese, si dhe monitorimi i internetit dhe komunikimeve të tjera elektronike, kanë provuar se janë mjete të efektshme për të luftuar veprimtaritë terroriste. Dëshmia e marrë përmes mbikëqyrjes elektronike duhet, siç parashikohet në ligjet përkatëse të vendit, të merret, në përgjithësi, në një formë që do të jetë ligjorisht e pranueshme në gjykatë, dhe metodat duhet të jenë në përputhje me detyrimet përkatëse të të drejtave të njeriut. Rregullimi i një mbikëqyrjeje të tillë mund të promovojë

⁶ Bashkëpunimi i brendshëm tashmë është theksuar nga UNCAC “Çdo Shtet Palë merr masa të tilla siç mund të jenë të nevojshme për të nxitur ... bashkëpunimin ndërmjet, nga njëra anë, autoriteteve publike të tij, si dhe zyrtarëve publikë të tij, dhe, nga ana tjetër, autoriteteve të tij që janë përgjegjës për hetimin dhe ndjekjen e veprave penale.” Ato masa mund të përfshijnë sigurimin e informacionit “me iniciativën e vet”, ose “sipas kërkesës”. UNCAC, neni 38.

⁷ Konventat e Kombeve të Bashkuara kanë bërë thirrje që shtetet palë “të lejojnë përdorimin e duhur nga ana e autoriteteve të tyre kompetente të ... teknikave speciale të hetimit, të tilla si ... operacionet e fshehta, ... dhe të lejojnë pranueshmërinë në gjykatë të provave që rrjedhin prej tyre.” UNCAC, neni 50.1; *Konventa kundër Krimin të Organizuar*, neni 20.1.

⁸ Konventa të ndryshme ndërkombëtare kanë dispozita për nxitjen e përdorimit të mbikëqyrjes elektronike. “Secili Shtet Palë... merr masat e nevojshme, brenda mundësive të tij, për të lejuar përdorimin e duhur nga ana e autoriteteve kompetente të ...

drejtpërsëdrejti të drejtën e personave që të mos jenë objekt i ndërhyrjeve arbitrare apo të paligjshme të privatësisë.⁹ Duhet të ekzistojë autorizimi i duhur ligjor nga autoritetet kompetente për të filluar mbikëqyrjen elektronike kundër një të dyshuari për terrorizëm. Ligjet që autorizojnë mbikëqyrjen elektronike duhet të jenë, gjithashtu, mjaft elastike për t'iu përgjigjur ndryshimeve të shpejta në teknologjinë e komunikimit, të cilat terroristët mund t'i shfrytëzojnë, dhe duhet të kërkojnë parimin ligjor të proporcionalitetit.

- *Praktika e Mirë 5: Përdorimi i stimujve për të dyshuarit terroristë dhe të tjerë që ata të bashkëpunojnë për qëllime të hetimeve dhe ndjekjeve penale antiterrorizëm.* Pa stimujt e duhur, ata që kanë dijeni mbi apo përfshirje në veprimtari terroriste mund të kenë pak arsye për të bashkëpunuar me autoritetet e zbatimit të ligjit, sidomos duke pasur parasysh frikën e hakmarrjes nga anëtarët e një organizate terroriste. Prandaj duhet të miratohen programe të përshtatshme me stimuj për të inkurajuar të dyshuarit terroristë dhe të tjerët që të sigurojnë informacion të saktë dhe të dobishëm për autoritetet kompetente në lidhje me veprimtaritë dhe komplotet terroriste.¹⁰ Çdo program i tillë duhet të respektojë parimin se askush nuk duhet të shtrëngohet të dëshmojë kundër vetvetes ose të pohojë fajësinë. Në lidhje me ata që janë përfshirë në planifikimin apo ndërmarrjen e aktiviteteve terroriste, sistemet ligjore duhet të kenë fleksibilitetin që të marrin parasysh bashkëpunimin me autoritetet, duke përfshirë edhe dhënien e dëshmisë në procedura të tjera penale, si dhe pranimin e fajit që në fillim për të zbutur dënimin.¹¹ Marrëveshjet formale të bashkëpunimit apo “marrëveshjet mbi pranimin e fajësisë” janë një mënyrë, por jo mënyra ekskluzive për të arritur këtë objektiv, pasi ka rregulla që adresojnë ndikimin e bashkëpunimit. Në fund, duhet pasur kujdes për t'u siguruar që stimujt për bashkëpunim nuk i shtyjnë individët të japin informacion apo dëshmi të rreme për organet e zbatimit të ligjit.

- *Praktika e Mirë 6: Miratimi i masave për të mbrojtur informacionet delikate të agjencive ligjzbatuese dhe shërbimit informativ në çështje të terrorizmit:* Në mënyrë që të mbrohen jetët e viktimave dhe informatorëve, burimet dhe metodat, dhe të ruhet vlera e teknikave hetimore delikate, qeveritë duhet të jenë në gjendje që të mbrojnë nga bërja publike disa lloje informacioni dhe teknikash, madje edhe gjatë procedurave të drejtësisë penale që janë publike. Duhet të miratohen masat e duhura ligjore mbrojtëse për të mbrojtur informacionin dhe teknika të tilla ndërsa të akuzuarit i mundësohet një gjykim i drejtë.¹² Ekzistojnë një sërë metodash që po aplikohen për mbrojtjen e informacionit të klasifikuar apo delikat të zbatimit të ligjit, të cilat përfshijnë, *inter alia*: a) mbajtjen e një seance dëgjimore të mbyllur; b) gjyqtari shqyrton

teknikave speciale të hetimit, të tilla si forma elektronike apo forma të tjera të mbikëqyrjes, ... dhe për të lejuar pranueshmërinë në gjykatë të provave që rrjedhin prej tyre.” *UNCAC*, neni 50.1; Marrëveshja *Konventa kundër Krimin të Organizuar*, neni 20.1. ⁹ *ICCPR*, neni 17.1.

¹⁰ Konventa të ndryshme të Kombeve të Bashkuara i bëjnë thirrje shteteve palë të marrin “masat e duhura për të inkurajuar personat që marrin pjesë apo që kanë marrë pjesë në kryerjen e një vepre penale të japin informacion të dobishëm për autoritetet kompetente për qëllime hetimore dhe dëshmuese.” *UNTOC*, neni 37.1, 31 tetor 2003, 2349 U.N.T.S. 41 [këtej e tutje *UNCAC*]; marrëveshja *UNTOC*, neni 26.1, 15 nëntor 2000, 2225 U.N.T.S. 209 [këtej e tutje *Konventa kundër Krimin të Organizuar*].

¹¹ Konventat e Kombeve të Bashkuara mbështesin uljen e dënimit ose dhënies së imunitetit për ata që bashkëpunojnë me agjencitë e zbatimit të ligjit. “Çdo Shtet Palë merr parasysh sigurimin e mundësisë, në raste të përshtatshme, për uljen e dënimit të një personi të akuzuar i cili siguron bashkëpunim thelbësor në hetimin ose ndjekjen e një vepre penale,” dhe “konsideron ofrimin e mundësisë ... e dhënies së imunitetit.” *UNCAC*, 1, nenet 37.2 dhe 37.3; marrëveshja *UNTOC*, nenet 26.2 dhe 26.3; *Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Trafikut të Paligjshëm të Drogave Narkotike dhe Lëndëve Psikotrope*, neni 7.18, 20 dhjetor, 1988, 1582 U.N.T.S. 95 [këtej e tutje *Konventa e OKB-së për drogat* (1988)].

¹²Tashmë ekzistojnë masa në nivel ndërkombëtar për të mbrojtur informatat e ndjeshme që një Shtet Palë merr nga një tjetër. “Shtetet Palë do të marrin masat e duhura në përputhje me legjislacionin e tyre vendas për të mbrojtur konfidencialitetin e çdo informacioni që ata marrin në mirëbesim në bazë të dispozitave të kësaj Konvente nga një Shtet tjetër Palë Nëse Shtetet Palë sigurojnë informacion për organizatat ndërkombëtare në mirëbesim, duhet të ndërmerren hapa për të siguruar që konfidencialiteti i informatave të tilla është i mbrojtur.” *Konventa Ndërkombëtare për Ndalimin e Akteve të terrorizmit bërthamor*, neni 7, 13 prill, 2005, 2445 U.N.T.S. 89 [këtej e tutje *Konventa për terrorizmin bërthamor*].

informacionin e përpunuar ose informacione të tjera për të përcaktuar nëse ato duhet të bëhen publike; ose c)) procedura të tjera të përshtatshme. Duke qenë se personat shpesh e ofrojnë këtë lloj informacioni për qeverinë në mirëbesim dhe në situata rreziku për sigurinë e tyre personale, këto masa ndihmojnë më tej mbrojtjen e jetës private të viktimave dhe informatorëve nga ndërhyrjet ose sulmet.¹³ Veç kësaj, kjo qasje mbron sigurinë kombëtare. Metodot e përmendura më lart janë në dispozicion për zbatim nga shtetet sistemet ligjore të të cilëve e lejojnë. Shtetet inkurajohen të zgjedhin metodat më të përshtatshme për rrethanat e tyre dhe në përputhje me legjislacionin e vendit, duke respektuar të drejtën ndërkombëtare në fuqi. Qeveritë, megjithatë, duhet të jenë të ndërgjegjshme për detyrën e tyre për të siguruar që të pandehurit të kenë një gjykim të drejtë, duke përfshirë të drejtën për t'u informuar për natyrën dhe shkakun e akuzës kundër tij.¹⁴

- *Praktika e Mirë 7: Mundësimi i ushtrimit të paraburgimit të ligjshëm të të dyshuarve për terrorizëm.* Paraburgimi, i miratuar nga gjykata dhe i mbikëqyrur, i të dyshuarve për terrorizëm, në rastet e dhura penale, është një mjet i domosdoshëm i një kuadri të efektshëm të drejtësisë penale kundër terrorizmit. Ky paraburgim do të sigurojë praninë e individit në gjykim dhe do të mbrojë shoqërinë nga rreziku që vjen nga i pandehuri. Baza ligjore e paraburgimit të të dyshuarve për terrorizëm dhe procedurat për rishikimin e këtij paraburgimi, si dhe kohëzgjatja e lejueshme e tij, ndryshon nga vendi në vend. Në çdo rast, megjithatë, paraburgimi duhet të jetë në përputhje me procesin e rregullt themelor, të kufizohet në rastet në të cilat është përcaktuar nevoja për paraburgim, dhe të administrohet në mënyrë të drejtë dhe pa ndikuar tek prezumimi i pafajësisë dhe të drejtat procedurale të individit të ndaluar.¹⁵ Në të njëjtën kohë, kushtet për paraburgim duhet të jenë mjaft elastike për të mbrojtur komunitetin kur është krijuar baza e duhur ligjore për të.¹⁶

- *Praktika e Mirë 8: Mundësimi i zhvillimit profesional të hetuesve, prokurorëve dhe gjyqtarëve të cilët merren me rastet e terrorizmit.* Për të siguruar ndjekje penale të efektshme është i nevojshëm një angazhim afatgjatë për zhvillimin dhe ndërtimin e një trupe të specializuar hetuesish, prokurorësh dhe gjykatësish (ku është e përshtatshme) të përhershëm të karrierës. Prokuroria e karrierës dhe shërbimet hetimore duhet të jenë të pajisur me infrastrukturën, shpërblimin dhe trajnimet e specializuara që ju nevojiten për të kryer funksionet kritike kundër terrorizmit në kuadër të sistemit të drejtësisë penale. Në veçanti, ata duhet të jenë në gjendje të trajtojnë aspektet komplekse ligjore, mjeko-ligjore, teknologjike dhe financiare të hetimeve dhe ndjekjeve penale të antiterrorizmit. Një gjyqësor kompetent dhe i paanshëm, i përshtatur për kompleksitetin dhe rëndësinë e rasteve të terrorizmit, duke përfshirë aspektet e të drejtave të njeriut, është gjithashtu i rëndësishëm për një qasje të efektshme të drejtësisë penale në luftën kundër terrorizmit brenda kuadrit të shtetit të së drejtës. Hetuesit, prokurorët dhe gjykatësit duhet të kenë në dispozicion trajnimet dhe burimet e nevojshme për të trajtuar këto raste në mënyrë të duhur.

¹³ Cf, *ICCPR*, neni 17.

¹⁴ *ICCPR*, neni 14.

¹⁵ *ICCPR* nenet. 9 dhe 14.

¹⁶ Nevoja e shteteve për të paraburgosur personat para gjyqit është e njohur në mënyrë të qartë dhe të autorizuar nga *ICCPR*, nenet 9, 10, dhe 14. Rregullimi i paraburgimit, në mungesë të një gjendjeje të jashtëzakonshme, duhet t'i nënshtrohet shqyrtimit gjyqësor, *ICCPR*, Neni 9.3 (që kërkon që personat e arrestuar për akuza penale të çohen menjëherë përpara një gjykatësi ose autoriteti tjetër gjyqësor) dhe neni 9.4 (që mbulon shqyrtimin gjyqësor të ligjshmërisë së çfarëdo forme të arrestimit apo ndalimit). [Sipas neni katër heqja formale e dispozitave për rishikimin gjyqësor të neni nëntë të *ICCPR-së* mund të shpallet gjatë një emergjence publike që kërcënon jetën e kombit, vetëm në masën që kërkohet rigorozisht nga nevojat, dhe me kusht që ato nuk janë në kundërshtim me të tjera detyrime ligjore ndërkombëtare dhe nuk imponohen në mënyrë diskriminuese...] *ICCPR*, neni 4.1.

- *Praktika e Mirë 9: Zhvillimi i praktikave dhe procedurave për të inkurajuar bashkëpunimin ndërkombëtar në fushën e antiterrorizmit.* Duke qenë se terrorizmi shpesh i kapërcen kufijtë kombëtarë, është i domosdoshëm bashkëpunim ndërkombëtar, i efektshëm dhe në kohë, për një reagim të drejtësisë penale ndaj terrorizmit. Ky bashkëpunim përfshin, por nuk kufizohet në, asistencën formale ndërkombëtare, si ekstradimi dhe ndihma e ndërsjellë juridike. Përcaktimi i një autoritet të vetëm qendror mund të jetë një rrugë përpara për të ndihmuar shtetet e tjera në gjetjen e autoritetit kompetent për trajtimin e kërkesave për ndihmë dhe për koordinimin e përpjekjeve. Efikasiteti dhe efektshmëria e bashkëpunimit formal ndërkombëtar do të rriten përmes: a) forcimi i autoriteteve qendrore për t'iu përgjigjur në mënyrë të efektshme kërkesave ndërkombëtare për ndihmë;¹⁷ b) rritjen e ndërgjegjësimit në mesin e prokurorëve dhe zyrtarëve të tjerë përkatës lidhur me kuadrin dhe praktikën për ekstradimin dhe ndihmën e ndërsjellë ligjore, në nivel shteti dhe në nivel ndërkombëtar; dhe c) forcimin e mirëkuptimit dhe besimit të ndërsjellë përmes masave të ndërtimit të besimit, duke pranuar se, në përputhje me të drejtën ndërkombëtare në fuqi, kërkesat për ekstradim apo ndihmë të ndërsjellë nuk duhet të refuzohen për arsye të papërshtatshme, përfshirë motivimin politik.¹⁸

Traktatet e ekstradimit dhe ndihmës së ndërsjellë juridike, si dhe legjislacioni vendas lidhur me to, duhet të përditësohen dhe të modernizohen sipas nevojës. Përveç kësaj, kur është e mundur dhe e përshtatshme, shtetet mund të zhvillojnë mjete të reja për të lehtësuar bashkëpunimin ndërmjet autoriteteve gjyqësore në vende të ndryshme.¹⁹ Në këtë drejtim, shtetet duhet të veprojnë në përputhje me detyrimet e tyre ligjore ndërkombëtare në lidhje me parimin e moskthimit dhe ndalimit të torturës dhe trajtimit mizor, çnjerëzor, ose degradues. Në dispozicion të autoriteteve qendrore, gjykatësve dhe prokurorëve duhet të ketë trajnime lidhur me parakushtet ndërkombëtare të të gjitha aspekteve të ndihmës së ndërsjellë juridike dhe bashkëpunimit gjyqësor.

Përveç mjeteve formale të bashkëpunimit sipas traktateve të ekstradimit, traktateve për ndihmë ligjore të ndërsjellë, dhe letërporosive, Shtetet, përmes kontakteve zyrtare të autorizuara, duhet të kërkojnë të nxisin bashkëpunimin përmes zhvillimit të rrjeteve të hetuesve dhe prokurorëve kundër terrorizmit, si pika kontakti, në mënyrë që të sigurojnë shkëmbim informacioni në “kohë reale” dhe në mënyrë të efektshme, në përputhje me ligjet dhe rregulloret përkatëse të secilit vend. Një bashkëpunim i tillë elastik inkurajohet nga e drejta ndërkombëtare dhe është i dobishëm për një sistem të efektshëm të drejtësisë penale kundër terrorizmit.²⁰

¹⁷ Shumë prej konventave ndërkombëtare që janë në fuqi përmbajnë masa për të rritur bashkëpunimin ndërmjet vendeve. Për shembull, shumë përmbajnë dispozita që kufizojnë arsyet e pranueshme për të mohuar një kërkesë ekstradimi. *UNCAC*, neni 44; *UNTOC*, neni 16; 1988; Konventa e OKB-së për drogat, neni 6; Konventa Ndërkombëtare për Ndalimin e Bombardimeve Terroriste, nenet 9 dhe 11, 24 tetor, 1995, 2149 U.N.T.S. 256 [këtej e tutje Konventa terroriste për shpërthimet]; Konventa Ndërkombëtare kundër marrjes së pengjeve, neni 10, 17 dhjetor 1979, 1316 U.N.T.S. 205 [në tekstin e mëposhtëm Konventa për pengjet]; Konventa e terrorizmit bërthamor, neni 13. Dispozitat e tjera theksojnë se “Shtetet Palë do t’i japin njëri-tjetrit masën më të gjerë të ndihmës së ndërsjellë juridike në hetimet, ndjekjet penale dhe procedurat gjyqësore”, me dispozita të veçanta për një autoritet qendror për trajtimin e të gjitha kërkesave. *UNCAC*, neni 46; Konventa për Krimin e Organizuar, neni 18; 1988, Konventa e OKB-së për drogat, neni 7.

¹⁸ Shih p.sh. Rezolutën 1373 të OKB-së (shtator 2001), para. 3(g), *Konventa kundër Bombardimeve Terroriste*, nenet 11 dhe 12.

¹⁹ Për shembull, Shtetet mund të marrin në konsideratë 1) lidhjen e marrëveshjeve ose përgatitjet që mundësojnë përdorimin e teknikave të posaçme të hetimit përtej kufijve kombëtarë të cilat mundësojnë pranueshmërinë e provave të tilla në gjykatat e tyre; b) shkëmbimin e magjistratëve ndërlidhës dhe atashëve të drejtësisë, pa paragjykuar legjislacionin vendas të tyre; dhe c) nëse, në një rast të caktuar dhe në përputhje me legjislacionin vendas, ekipet e përbashkëta hetimore mund të çojnë më tej interesat e bashkëpunimit ndërkombëtar në luftën kundër terrorizmit. Shih p.sh. *UNTOC*, Neni 19.

²⁰ Janë miratuar konventa të ndryshme që përmbajnë dispozita të cilat promovojnë bashkëpunimin ndërkombëtar jo formal. Për shembull, *UNCAC*-i parashikon që Shtetet Palë duhet të “marrin masa të efektshme për të përmirësuar dhe, kur është e

- *Praktika e Mirë 10: Zhvillimi dhe përdorimi i provave mjeko-ligjore për të përcaktuar identitetin e personave të përfshirë në akte terroriste.* Përdorimi i shkencave moderne mjeko-ligjore, të pranuar shkencërisht, në përputhje me të drejtat e njeriut, është një instrument i paçmuar në hetimet e terrorizmit. Këto masa mund të përfshijnë analizën e ADN-së moderne, analizën automatike të gjurmëve të gishtave, balistikën, analizën e mbetjeve të bombës, dhe një mori mjetesh të tjera. Megjithatë, duhet pranuar se prova mjeko-ligjore mund të mos jetë gjithmonë e pranishme në skenat e krimit, dhe në mungesë të provave të tilla, identiteti i autorit mund të zbulohet me anë të mjeteve të tjera të ligjshme. Autoritetet e zbatimit të ligjit dhe autoritetet e tjera të cilat shkojnë të parat në vendin e krimit duhet të bëjnë të pamundurën për të ruajtur integritetin e vendit të ngjarjes në mënyrë që të rritet mundësia për marrjen e provave të dobishme, që të mund të kryhet ekzaminimi i duhur mjeko-ligjor. Ato duhet të marrin në konsideratë nxjerrjen e udhëzimeve për të çuar më tej këtë objektiv. Në raste të veçanta ndihma ndërkombëtare mund të jetë e dobishme për sigurimin e vendit të ngjarjes apo për mbledhjen, mbrojtjen, dhe ekzaminimin e provave mjeko-ligjore. Së fundi, disponueshmëria e mjeteve të mjekësisë ligjore ndihmon drejtpërdrejt për mbrojtjen e të drejtave të njeriut duke rritur numrin e mjeteve për të zbuluar identitetin e të dyshuarve për terrorizëm përmes mjeteve jo-shtrënguese.

- *Praktika e Mirë 11: Të sigurohemi që terroristët e dënuar marrin dënimin e merituar dhe të zhvillojmë politika për burgosjen dhe ri-integrimin e tyre.* Një pjesë kritike e një përgjigje të efektshme të drejtësisë penale ndaj terrorizmit është një sistem i efektshëm për burgosjen e terroristëve të dënuar. Një sistem i tillë duhet të sigurojë dënimin e duhur për të penguar veprimtarinë terroriste, parandalojë radikalizmin e mëtejshëm të të burgosurve, parandalojë që aktivitetet terroriste të drejtohen ose të marrin mbështetje nga brenda sistemit të burgjeve, dhe të sigurojë çradikalizmin dhe riintegrimin e të burgosurve në shoqëri, ku është e mundur, duke reduktuar kështu recidivizmin.

- Terroristët e dënuar duhet të mbahen të sigurt për kohëzgjatjen e burgimit të tyre, e cila duhet të reflektojë seriozitetin e veprës dhe dëmin potencial për shoqërinë nga sjellja e tyre, duke i trajtuar ata në mënyrë njerëzore dhe duke respektuar të drejtat e tyre.²¹ Përvoja ka treguar se disa terroristë të dënuar vazhdojnë të kryejnë veprimtari terroriste gjatë burgosjes së tyre. Qeveritë duhet të miratojnë masa - të tilla si kufizime proporcionale të komunikimeve të terroristëve të dënuar - për të parandaluar që të ndodhin aktivitete të tilla.

Shtetet inkurajohen që të ndajnë me njëri-tjetrin përvoja të tjera përkatëse dhe informacion në lidhje me burgosjen dhe riintegrimin e terroristëve. Shtetet mund të përdorin përvojat dhe informacionet nga qeveritë që kanë patur sukses në rehabilitimin e personave të dënuar për

nevojshme, për të vendosur kanalet e komunikimit ndërmjet autoriteteve të tyre kompetente, agjencive dhe shërbimeve me qëllim të lehtësimit të shkëmbimit të shpejtë të informacionit në lidhje me të gjitha aspektet e veprave [penale]". UNCAC, neni 48; Konventa kundër krimit të organizuar, neni 27; Konventa e OKB-së kundër drogave, (1988), neni 9. Dispozitat e tjera parashikojnë shkëmbimin e informacionit për të ndihmuar në parandalimin e veprave penale, ose ndarjen e dëshmimeve pasi është kryer një vepër penale. Konventa për Ndalimin e Akteve të Paligjshme lidhur me Aviacionin Civil Ndërkombëtar, neni 18, 10 shtator 2010 [këtej e tutje Konventa e Pekinit] ("Çdo Shtet Palë që ka arsye për të besuar se [një vepër] ... do të kryhet, në përputhje me legjislacionin e vet vendas, t'u japë Shteteve Palë çdo informacion të rëndësishëm që posedon."); *Konventa kundër bombardimeve terroriste*, neni 15 ("Shtetet Palë do të bashkëpunojnë në parandalimin e veprave [penale] duke shkëmbyer informacion të saktë dhe të verifikuar në përputhje me legjislacionin e tyre vendas.")

²¹ Parimet dhe filozofia e përqafuar në Rezolutat për Rregullat Standarde Minimale për Trajtimin e të Burgosurve dhe Rezolutat e Këshillit Ekonomik dhe Social 666 C (XXIV) dhe 2076 (Lxii), (31 korrik 1957 dhe 13 maj, 1977), të Kombeve të Bashkuara sigurojnë një udhëzues të dobishëm dhe fleksibël që vendet duhet ta përdorin kur të vendosin se çfarë kushtesh izolimi janë të përshtatshme për të burgosurit. Megjithatë, siç vihet në dukje tek vetë Rregullat "është e qartë se jo të gjitha rregullat janë të afta të zbatohen në të gjitha vendet dhe në të gjitha kohët." Id. në f. 1, Vëzhgimi paraparak 2. Kështu, disa nga rregullat e sugjeruara mund të kenë nevojë të ndryshohen për të ofruar mbrojtje nga ata që kërkojnë të vazhdojnë veprimet e tyre terroriste që nga brenda burgut.

kryerjen e veprave penale të terrorizmit dhe në largimin e tyre nga dhuna. Duhet të ndërmerren masa për riintegrimin në shoqëri të të burgosurve që do të dalin në komunitet. Kur është e përshtatshme dhe në përputhje me ligjet përkatëse të vendit, këto masa përfshijnë kushte të rrepta lirim, mbikëqyrur nga gjykata.

B. Veprat penale

- *Praktika e Mirë 12: Kriminalizimi i terrorizmit, siç është përcaktuar në konventat ndërkombëtare dhe protokollet në fuqi.* Edhe pse Shtetet mund t'i qasen kodifikimit të terrorizmit në mënyra të ndryshme, varësisht nga traditat ligjore të tyre, ato duhet të kriminalizojnë veprat penale të përshkruara në instrumentet ligjore ndërkombëtare përkatëse kundër terrorizmit tek të cilat ato janë palë, ose të cilat kërkohen nga rezolutat përkatëse të Këshillit të Sigurimit të OKB-së, si pjesë e një kornize gjithëpërfshirëse ligjore për të luftuar dhe për të parandaluar terrorizmin.²² Për më tepër, Shtetet që nuk janë palë në disa ose të gjitha këto instrumente ndërkombëtare duhet të konsiderojnë të bëhen palë.²³ Përfshirja e duhur e dispozitave dhe detyrimeve ndërkombëtare kundër terrorizmit në legjislacionin e vendit përbën një element kyç në një kuadër ligjor gjithëpërfshirës dhe koherent kundër terrorizmit që është mjaft i saktë në komunikimin e drejtë të sjelljes së ndaluar dhe ruan keqpërdorimin e mundshëm me ligjet penale.

- *Praktika e Mirë 13: Kriminalizimi i kompleteve, kërkimit të terrorizmit dhe akteve të tjera përgatitore të terrorizmit.* Kriminalizimi i akteve përgatitore, të tilla si komploti, mbledhja e fondeve terroriste, rekrutimi terrorist, planifikimi dhe trajnimi, veçanërisht kur një sulm terrorist nuk është kryer ende, është jetik për një qasje të efektshme parandaluese të drejtësisë penale në luftën kundër terrorizmit. Autoritetet duhet të jenë në gjendje të përqendrojnë vëmendjen e tyre tek ndërhyrja proaktive kur të dyshuarit terroristë janë në fazat e planifikimit dhe të përgatitjes në mënyrë që të reduktohet dhuna terroriste dhe që sulmet të shkatërrohen para se të ndodhin. Ndërsa vendet ndryshojnë në mënyrën se si janë përcaktuar saktësisht këto vepra (p.sh., anëtarësimi në një organizatë terroriste, drejtimi i veprimtarisë së organizatave terroriste, kërkimi, nxitja apo rekrutimi) penalizimi i akteve përgatitore do të lehtësojë në mënyrë të konsiderueshme ndërhyrjen që në fazat e para. Krijimi i veprave penale për komplot apo shoqërim kriminal, të cilat ndalojnë marrëveshjet për kryerjen e krimeve të lidhura me terrorizmin, është jetik për të lehtësuar këtë ndërhyrje që në fillim. Që këto vepra të jenë të plota, sulmet terroriste nuk duhet të tentohen ose të realizohen, por duhet që vetëm të jetë rënë dakord për to, apo të jenë përgatitur në ndonjë mënyrë. Në kriminalizimin dhe ndjekjen penale të këtyre akteve, vendet duhet të respektojnë plotësisht të drejtat e individëve për lirinë e shprehjes, lirinë e fesë apo besimit, si dhe lirinë e shoqërimit.

- *Praktika e Mirë 14: Kriminalizimi i tentativave për të kryer dhe për të ndihmuar e mbështetur aktet terroriste.* Gjithashtu, vendet duhet të miratojnë ligje që kriminalizojnë tentativën për të kryer, ose për të ndihmuar apo mbështetur kryerjen e veprave të terrorizmit.²⁴ Kriminalizimi i

²² Disa vepra të lidhura me terrorizmin janë të mbuluara tashmë nga konventat ndërkombëtare specifike që iu kërkojnë shteteve palë të kriminalizojnë ato veprime. Shih p.sh. Konventa për pengjet, shënimi *Supra* 10, neni 1 (penalizon “pengmarrjen”); Konventa kundër bombardimeve terroriste, neni 2 (e bën të paligjshëm “ofrimin, vendosjen, lëshimin, ose shpërthimin e një mjeti shpërthyes apo pajisjeje tjetër të paligjshme”); Konventa për terrorizmin bërthamor, neni 2 (e bën veprë penale bërjen, posedimin, ose përdorimin e materialit ose një pajisjeje radioaktive, ose dëmtimin e një impianti bërthamor).

²³ Shih, Rezoluta 1373 para. 3(d) i KS të OKB-së.

²⁴ Konventat ndërkombëtare zakonisht kriminalizojnë çdo përpjekje për të kryer veprë penale të mbuluar nga kjo Konventë. Shih *UNCAC*, neni 27.2; *Konventa kundër Bombardimeve Terroriste*, neni 2.2; *Konventa kundër marrjes së pengjeve*, neni 1.2; *Konventa e OKB-së për ndalimin dhe ndëshkimin e krimit të genocidit*, neni 3 (d); Statuti i Tribunalit Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë, neni 4.3; Statuti i Tribunalit Ndërkombëtar për Ruandën, neni 2.3. Të njëjtat konventa ndërkombëtare shpesh quajnë krim pjesëmarrjen në një veprë si bashkëpunëtor. Shih *UNCAC*, neni 27.1; *Konventa kundër Bombardimeve Terroriste*,

përpjekjeve, madje edhe kur autori, në fund, nuk ka patur sukses në kryerjen e krimit, është thelbësor, në kuadër të parandalimit, në një sistem të drejtësisë penale.

- *Praktika e Mirë 15: Kriminalizimi i financimit të terrorizmit.* Pengimi që terroristët dhe organizatat terroriste të financojnë aktivitetet e tyre është një element përbërës thelbësor i çdo strategjie të suksesshme kundër terrorizmit dhe një kërkesë e detyrueshme e disa rezolutave të Këshillit të Sigurimit të OKB-së.²⁵ Vendet duhet të miratojnë ligje që kriminalizojnë financimin e terrorizmit, në përputhje me Konventën Ndërkombëtare për Shtypjen e Financimit të Terrorizmit, dhe inkurajohen që të zbatojnë Rekomandimet e Task Forcës për Veprime Financiare për kriminalizimin e financimit të terrorizmit.²⁶ Duhet të miratohen procedurat dhe mekanizmat e duhur që lejojnë ngrirjen, sekuestrimin dhe konfiskimin e pasurive terroriste dhe fondeve të përdorura ose të caktuara për qëllime të financimit të terrorizmit, në pajtim me rezolutat përkatëse të Këshillit të Sigurimit të OKB, dhe objekt i rishikimit të duhur.

Përfundim: Rritja e kapaciteteve

Është jetike që Shtetet të ndihmojnë njëri-tjetrin për zhvillimin e kapaciteteve të nevojshme për t'u përballur me terrorizmin nëpërmjet sistemit të drejtësisë penale. Prandaj shtetet duhet, në radhë të parë, të kenë një sistem modern, të drejtë dhe të efektshëm të drejtësisë penale që formon bazën për një përgjigje të fortë të drejtësisë penale ndaj terrorizmit. Kështu, ngritja e kapaciteteve është një element thelbësor në një program të efektshëm antiterrorizëm. Ky Grup Pune inkurajon të gjitha shtetet dhe organet shumëpalëshe përkatëse që të marrin pjesë në përpjekje të tilla.

Duhen hartuar programe për ngritjen e kapaciteteve për të siguruar që zyrtarët e zbatimit të ligjit dhe të drejtësisë penale të kuptojnë dhe të zbatojnë praktikën e mira të diskutuara më lart, që janë në përputhje me kërkesat ligjore dhe rrethanat e tyre. Për më tepër, zbatimi antiterrorizëm duhet të zhvillohet brenda një kuadri që respekton të drejtat e njeriut dhe promovon sundimin e ligjit dhe qeverisjen e mirë.

Shtetet inkurajohen që të paraqesin ofertat e ndihmës dhe kërkesat për ndihmë pranë Njësisë Administrative të FBAT-së duke përdorur formularin në shtojcën e bashkëngjitur për të përmirësuar bashkëpunimin në përpjekjet për ndërtimin e kapaciteteve në luftën kundër terrorizmit në një mënyrë që është më së miri në përputhje me prioritetet dhe sistemet ligjore, si dhe me rrethanat e veçanta të secilit shtet. Drejtuesit e Grupit të Punës, në bashkëpunim me Njësinë Administrative të FBAT-së, do të shkëmbejnë kërkesat dhe ofertat për ndihmë me të gjithë anëtarët e Grupit të Punës për kohën e duhur dhe rregullisht.

Ky Grup Pune pranon se asnjë shtet nuk është i detyruar të japë apo të marrë ndihmë. Ofertat apo kërkesat duhet të bazohen në vendimin sovran të çdo shteti në bazë të sistemit ligjor,

neni 2.3; *Konventa kundër marrjes së pengjeve*, neni 1.2; *Konventa e OKB-së për ndalimin dhe ndëshkimin e krimit të genocidit*, neni 3 (e) (e bën të dënueshme “bashkëfajësinë në genocid”); *Statuti i Tribunalit Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë*, neni 4.3 (e bën të dënueshëm “pjesëmarrjen në genocid”); *Statuti i Tribunalit Ndërkombëtar për Ruandën*, neni 2.3 (e bën të dënueshme “bashkëfajësinë në genocid”).

²⁵ Shih, p.sh. Rezolutën 1267 (1999) të KS të OKB-së; Rezolutën 1373 (2001) të KS të OKB-së.

²⁶ Përveç Konventës Ndërkombëtare për shtypjen e financimit të terrorizmit, konventa të tjera ndërkombëtare ndalojnë aktivitetet e atyre që “me vetëdije financojnë” veprat penale të përcaktuara në këtë konventë të veçantë. *Shih Konventën kundër Bombardimeve Terroriste*, neni 15; *Konventa për terrorizmin bërthamor*, neni 7.1.

përparësitë, nevojat dhe rrethanat e tij.

Grupi i Punës rekomandon që Shtetet të marrin në konsideratë përqendrimin e përpjekjeve të tyre për ngritjen e kapaciteteve përkatëse kundër terrorizmit rreth parimeve të mëposhtme:

Përdorimin e praktikave të renditura mirë si një mjet për të udhëhequr rritjen e kapaciteteve: Grupi i Punës inkurajon të gjitha shtetet që të marrin në konsideratë përdorimin e praktikave të mira si një udhërrëfyes jo detyrues për zbatimin e aktiviteteve të asistencës për ngritjen e kapaciteteve kundër terrorizmit. Shtetet duhet të mbajnë parasysh se praktikatat e mira më sipër mund të përditësohen me kalimin e kohës për të përfshirë përvojat e vendeve lidhur me përdorimin e sistemeve të tyre të drejtësisë penale për të luftuar dhe për të parandaluar terrorizmin.

Rritjen e përqendrimit tek zhvillimi institucional. Përpjekjet e efektshme për të luftuar terrorizmin - dhe për të kryer hetime proaktive - shpesh do të kërkojnë reforma dhe rritjen e profesionalizimit dhe specializimit të organeve përkatëse të drejtësisë penale.²⁷

Koordinimin e mëtejshëm të agjencive qeveritare. Siç u përmend më lart një nga pengesat themelore për hetim dhe ndjekje penale të efektshme është shpesh mungesa e koordinimit, bashkëpunimit, dhe shkëmbimit të informacionit midis agjencive të sigurisë publike, zbatimit të ligjit, informative, dhe prokurorisë. Inkurajimi i mekanizmave institucionalë, të tilla si task forcat ndërinstitucionale, për të bashkërenduar punën ndërmjet agjencive të ndryshme të qeverisë është kyç për tejkalimin e pengesave.

Inkurajimin e Zhvillimit të Aftësive dhe Ekspertizës së Specializuar. Siç u përmend më lart, shtetet duhet të marrin parasysh zhvillimin e një kuadri profesional të punonjësve në çdo element përbërës²⁸ të sistemit të drejtësisë penale, që të përdorin në mënyrë të efektshme sistemin e drejtësisë penale për të luftuar terrorizmin. Duke pasur parasysh natyrën gjithnjë e më komplekse dhe shumë të specializuar të hetimeve dhe ndjekjeve penale kundër terrorizmit, shtetet mund të përfitojnë nëse ju sigurojnë trajnim dhe aftësim të specializuar kundër terrorizmit zyrtarëve të zbatimit të ligjit, gjyqtarëve, prokurorëve për të zhvilluar dhe zbatuar mjetet e lartpërmendura në mënyrë të efektshme. Duke pasur parasysh natyrën ndërkombëtare të kërcënimit terrorist, me rëndësi thelbësore është edhe ekspertiza e specializuar në bashkëpunimin ndërkombëtar, duke përfshirë zhvillimin e autoriteteve qendrore të efektshme.

²⁷ Disa konventa ndërkombëtare sigurojnë që autoritetet e specializuara të merren me një çështje të caktuar. *UNCAC*-i, për shembull, thotë se secili shtet palë do të “sigurojë ekzistencën e një organi ose organet ose personat e specializuar në luftimin e korrupsionit përmes zbatimit të ligjit. Këta organe ose organet ose personat do të kenë pavarësinë e nevojshme ... që të jenë në gjendje të kryejnë funksionet e tyre në mënyrë të efektshme dhe pa ndonjë ndikim të tepruar. Personat ose stafi i këtij organi apo këtyre organeve duhet të ketë trajnimin dhe burimet e duhura për të kryer detyrat e tyre.” *UNCAC*, neni 36.

²⁸ Në strategjinë globale kundër terrorizmit të OKB-së, Asambleja e Përgjithshme pranon “që shtetet mund të kërkojnë ndihmë në zhvillimin dhe mirëmbajtjen e [një] sistemi të drejtësisë penale të efektshëm dhe të bazuar në ligj” dhe “i inkurajon ato që të mbështeten tek asistencat teknike e ofruar, Inter alia, nga Zyra e Kombeve të Bashkuara për Drogat dhe Krimin. “Strategjia e OKB-së, Plani i Veprimit, Seksioni 4, Paragrafi 4. Përveç kësaj, konventat e Kombeve të Bashkuara e kanë njohur rëndësinë e trajnimit të specializuar në të gjithë spektrin e sistemit të drejtësisë penale. “Çdo Shtet Palë do të ... fillojë, zhvillojë, ose përmirësojë programe specifike trajnimi për personelin e saj të zbatimit të ligjit, duke përfshirë prokurorët, gjyqtarët hetues dhe personelin doganor, dhe stafin tjetër të ngarkuar me parandalimin, zbulimin dhe kontrollin e veprave penale të mbuluara nga kjo Konventë.” *UNTOC*, neni 29.